



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot Br. Prot Prot No
2-D/DPK	01-1492/14
Nr. i taq. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
02	28.04.2014



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 25.04.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-3540/13, për z. Dashamir Bërxulli – Prodekan për çështje mësimore në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit, por ka disa kufizime.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Dashamir Bërxulli – Prodekan për çështje mësimore në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (në tekstin e mëtejme Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Në rastin e lartpërmendur, zyrtari i lartë z. Bërxulli është hetuar për situatë të konfliktit të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksioneve publike si Prodekan për çështje mësimore në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe Anëtar i Këshillit Drejtues të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, dhe njëkohësisht bashkëpronar dhe person i autorizuar në biznesin privat Sh.P.K “Passion Group”.

Zyrtari i lartë z. Bërxulli, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimi të kësaj shkrese, është organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z. Bërxulli është bindur për kufizimin si bashkëpronar dhe person i autorizuar në biznesin privat dhe ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për ti bërë ndryshimet e nevojshme për të shmangur konfliktin e interesit.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI-03-1133/14), në të cilën vërtetohet se i njëjti është larguar nga bashkëpronësia dhe nga të qenurit person i autorizuar.

Sa i përket funksionit tjetër publik, si Anëtar i Këshilli Drejtues të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, konsiderojmë se z. Bërxulli mund ta ushtroj këtë funksion nën kufizimet e parapara në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Ligj në fjalë përcakton se zyrtari i lartë mund të ushtroj veprimtari tjera krahas ushtrimit të funksionit publik. Ushtrimi i këtyre veprimtarive parashihet në nenin 10 (paragrafi 2) në të cilin thuhet: *“Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, zyrtari i lartë mund të ushtrojë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarisë humanitare, nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera”*.

Megjithatë, neni 15 (paragrafi 3) i po këtij ligji parasheh kufizimet gjatë ushtrimit të këtyre funksioneve. Në këtë nen shprehimisht thuhet: *“Zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organeve drejtuese dhe mbikëqyrës i personave juridik jo fitimprurës dhe personave juridik tjerë të cilat kryejnë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarive humanitare, por nuk ka të drejtë të pranimi të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme, për veç nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera”*.

Bazuar në këtë dispozitë, z. Dashmir Bërxulli, si Anëtar i Këshillit Drejtues të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës mund të pranoj kompensimin e përcaktuar me Vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (Nr.104/2013, të datës 30.12.2013), por jo të pranoj kompensim për shpenzime të udhëtimit dhe shpenzime tjera të nevojshme.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

